



## **KASA CONSTRUCTION**

**NIPT L08707101F**

MAGAZINIM, RIKUPERIM I HEKURISHTEVE/SKRAPEVE TE METALIT OSE CMONTIM I MBETJEVE NGA MOTORET E AUTOMETJEVE NE FUND TE JETES.


**LOERMA SH.P.K**

RRUGA E RE ELBASAN  
MYSLYM SHYRI TIRANE

+355 69 97 84 802

[www.loerma.com](http://www.loerma.com)

11/14/2016



EKSPERT  
LOERMA  
SH.P.K  
10202041  
ELBASAN

## **PASQYRA E LËNDËS:**

- 1. KUADRI LIGJOR, RREGULLATOR**
- 2. PËRSHKRIM I MJEDISIT**
- 3. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT**
- 4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS**
- 5. MASAT PËR MINIMIZIMIN DHE MONITORIMIN E NDIKIMEVE NË**  
**MJEDIS**



## **1. KUADRI LIGJOR, RREGULLATOR**

- Ligji Nr 10431, datë 09.06. 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".
- Ligji Nr 10440, datë 07 .07. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis".
- Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit".
- Ligji Nr.8897, datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".
- Ligj Nr.9115, datë 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura"
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit"
- Ligji Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".
- Vendim Nr. 452, datë 11.7.2012 "Për lendfillet e mbetjeve".
- Vendim Nr. 175 datë 19.1.2011 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të Meaxhimit të Mbetjeve.
- Vendim Nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e afateve për zhvillimin e procedurës së VNM-së dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore".
- Vendim Nr. 313, datë 09.05.2012 "Për rregulloren e mbrojtjes së publikut nga shkarkimet në mjedis".
- Vendim Nr.1189, datë 18.11.2009 "Për Rregullat dhe Proçedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit".
- Vendimi Nr.247, datë 30.04.2014 "Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrjen për mjedisin".
- Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 "Për menaxhimin e zhurmave"
- Vendim Nr. 177, datë 6.3.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"
- Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse".
- Vendim Nr. 435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë.

Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, është mbështetur në legjislacionin mjedisor si më lartë dhe ka për qëllim që të identifikojë, parashikojë dhe monitorojë ndikimin e këtij aktiviteti në mjedis. Kuadri ligjor për VNM-në sigurohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri; Ligji "Për Mbrojtjen e Mjedisit" dhe Ligji "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis". VNM është një proces sistematik për të përcaktuar dhe vlerësuar efektet apo ndikimet në mjedis të një veprimi apo projekti të caktuar. Në një situatë normale, ky proces aplikohet përpara se të merret vendimi dhe të fillojnë angazhimet për realizimin e projektit. Por sidoqoftë, dhe në çdo kohë, efektet sociale, kulturore dhe shëndetësore janë konsideruar si pjesë integrale e VNM-së. Kujdes i veçantë i kushtohet praktikave të VNM-së për të parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative të veprimeve të ndermarra. Qëllimi i VNM-së është informues (të japë informacion për pasojat mjedisore të studimeve të propozuara) dhe këshillues (përmirësim nga pikëpamja mjedisore të propozimit dhe projektit).



## **2. PËRSHKRIM I MJEDISIT**

### **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME**

Zona Gjeografike: Peqini kufizohet në veri me bashkinë Tiranë, në lindje me bashkinë Elbasan, në jug-lindje me bashkinë Cërrik, në jug-perëndim me bashkinë Lushnje dhe në jug me bashkinë Belsh. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Peqinit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Peqini ka një popullsi prej 26.136 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 38.900 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 197.79 km<sup>2</sup> me një densitet prej 196.67 banorë/km<sup>2</sup> sipas regjistrimit civil dhe 132 banorë/km<sup>2</sup> sipas censurit.

Kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Peqin, Pajovë, Karinë, Përparim, Gjocaj dhe Shezë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Peqinit dhe qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 50 fshatra.

### **PROFILI I BASHKISË**

Bashkia e re e Peqinit shtrihet përgjatë rrugës së vjetër Egnatia, ndërsa kalaja Klaudiana në qendër të qytetit është dëshmi e lashtësisë së këtij vendbanimi. Qyteti dhe të 50 fshatrat e kësaj bashkie shtrihen në një zonë fushore dhe kodrinore.

Banorët e bashkisë së Peqinit janë të orientuar ndaj bujqësisë dhe vreshtarisë, por edhe mbarështimit të shpendëve. Kultivimi i ullinjve, i perimeve të serave dhe i produkteve të tjera bujqësore janë gjithashtu karakteristikë e zonës.

Peqini është i njohur për rritjen e gjelit të detit, mjaft i kërkuar në të gjithë Shqipërinë në kohë festash si dhe për sportin e ndeshjeve me gjela.

Bizneset janë kryesisht të përqendruar në shërbime, ndërkohë që në Peqin janë ngritur edhe disa punishte për vajin e ullirit.

Problemi më i madh i Peqinit është punësimi. Edhe pse një pjesë e mirë e banorëve merren me bujqësi, mundësitë ekonomike për ta janë të pakta. Sfidat e bashkisë së re janë të harmonizojë zonën urbane me zonën rurale si dhe hapja e bizneseve prodhuese, që mund t'i jepnin një hov punësimit të banorëve të Peqinit.

### **KUSHTET GJEOLOGJIKE DHE GJEOMORFOLOGJIKE**

Zona e Peqinit përfshihet në Zonën Jonike, e cila karakterizohet nga depozitime që përfshijnë një diapason kohor nga Triasi deri në ditën e sotme. Pjesa Qëndrore dhe Perëndimore e Zonës Jonike Përfaqësohet nga Ultësira Pranë Adriatike, në të cilën përfshihet dhe zona e gjerë e Durrësit. Në ultësirën pranë adriatike takohen disa kodra, të cilat përfaqësojnë struktura Antikinale dhe disa zona të rrafshhta që përfaqësojnë struktura sinklinale. Ultësira ndërtohet nga depozitime neogjenike të cilat përfaqësohen nga shkëmbinjtë argjilorë, alevrolite, conglomerate dhe ranore.

### **SIZMICITETI**

Shqipëria është një vënd me një shkallë të lartë sizmiciteti. Sizmiciteti i Shqipërisë lidhet me lëvizjen konvergjente midis orogjenit shqiptar në Jug-Lindje dhe mikroplakës së Adrais në Veri-Perëndim. Orojeni shqiptar ndahet në dy zona me regjim të ndryshëm tektonik; zona bregdetare në kompresion e dominuar nga ngjeshjet VP-JL dhe zona e brëndëshme në tërheqje e dominuar nga thyerjet nominale me drejtim verior. Sizmiciteti rajonal i Shqipërisë lidhet me 7 nënzona sizmogjene.

### UJËRAT SIPËRFAQËSORË DHE NËNTOKËSORË.

Ujrat paraqesin një burim të konsiderueshëm për Shqipërinë. Rrjeti lumor është shumë kompleks, me një sipërfaqetë pellgut ujëmbledhës prej rreth 43305 m<sup>2</sup>. Të gjithë lumenjtë shkarkojnë në Detin Adriatik dhe kanë përgjithësisht drejtim Lindje – Perëndim. Lumenjtë kryesorë janë Buna, Drini, Ishmi, Erzeni, Shkumbini, Semani dhe Vjosa. Sasia e ujrave rrjedhës sipërfaqësorë ulet shumë gjatë muajve të verës. Vetëm 6-9% të reshjeve vjetore janë vërejtur gjatë stinës së thatë (Korrik-Shtator). Lumenjtë Shqipëtarë karakterizohen nga prurjet e mëdha. Prurja mesatare e përgjithëshme është rreth 1308 m<sup>3</sup>/s, ndërkohë që prurjet maksimale janë shumë të larta. Prurjet mesatare transportojnë 53250000 ton aluvione në vit, e barabartë me 1650 kg/s. prurjet maksimale takohen gjatë periudhës së lagësht të vitit dhe përfaqësojnë 82% të volumit vjetor.

Zona e Peqinit ka burime të rralla ujore, si sipërfaqësore ashtu dhe nëntokësore. Nuk ka ndonjë lum me rrjedhje të vazhdueshme në këtë zonë. Lumi më i afërt është Lumi Shkumbin, në perëndim të zonës. Kështu që zhvillimi i kësaj fushe është i ulët, pjerrësia natyrale nuk është emjaftueshme për të krijuar rrjedhje në drejtim të Detit Adriatik.

Cilësia e ujrave nëntokësore të zonës nuk është ekënaqshme. Shumica e puseve artezianë kanë dhënë ujë brënda kufijve të standarteve të ujit të pijshëm. Uji është zakonisht i rëndë, me përmbajtje klori dhe natriumi. Përqëndrimi i hekurit kalon kufirin standart të ujit të pijshëm prej 0.2mg/l.

Sipas studimit të zonës, ujrat nëntokësorë janë freatikë me drejtim rrjedhjeje juglindor. Thelësia e ujrave nëntokësorë, është përcaktuar gjatë rievimeve fushore.



Vend-ndodhja e propozuar per ngritjen e instalimit te ri, shtrihet ne nje zone fushore me seli ne Elbasan, fshati Gjocaj Bardhaj, Lagjja Bardhas,

Shoqeria eshte e pajisur me leje mjedisi per aktivitetin " prodhim te materialeve te ndertimit, tregetim te materialeve te ndertimit, pllaka porcelain, qeramike, kolle, bojra etj.  
Per kete veprimtari ajo eshte paisur me Leje Mjedisi PN-1442-02-2011 Kodi III.1.B.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Ministria e Ekonomisë,  
Tregtisë dhe Energjetikës

## LEJE




PN-1442-02-2011	KASA CONSTRUCTION	Emërtimi pershkues i veprimtarisë
Kodi: III.1.B	NUIS/NIPT: L08707101F	Leje mjedisore për "Pike magazinimi dhe tregtimi për materiale ndërtimi".
Data e lëshimit: 21/02/2011	Elbasan, FERGJIN, Gjocaj, BARDHAI, Lagjja Bardhas,	
Afati i vlefshëm: Pa afat		
Kategoria Për ndikimin në mjedis		Kod tjetër:
Nënkategoria Leje mjedisore		Kufizime specifike Leje ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi
Veprimtari specifike		Detvime specifike 1. Gjeneri bashkëngjitur aktin ratimin per kete subjekt 2. Gjeneri bashkëngjitur me Lejen kushtet per t'u zbatuar, per minimizimin e ndikimeve ne mjedis. Leje ushtrohet sipas detjimeve në legjislacionin në fuqi
Specialtet		Vendi i kryerjes së veprimtarisë Qarku: Elbasan, Rrethi: FERGIN, B/K: GJOCAJ, Q/F: BARDHAI, Adresa: Lagjja Bardhas, magazine në kryqezimin Bardhaj-Gjocaj

Nënshtkrimi i sportelit: \_\_\_\_\_

EKSPERTI MJEDISI  
LOJZETA  
L08707101F  
ELBASAN

Shoqëria "Kasa Construction" shpk do ta ushtrroje aktivitetin e saj ne prone te vete, bashkengjitur Vertetimi Hipotekor.

  
**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

**ÇERTIFIKATË** 155649  
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit T E Q I N Zona Kadastrale Nr. 1112  
Numri i Pasurisë 32/15 Volumi 5 Faqe B  
Adresa e Pasurisë BARJHAS  
Lloji i Pasurisë AMB + TRUALL + MAGAZINET + ZYRA NEB KN  
Sipërfaqja Totale 4416M<sup>2</sup>  
Nga kjo : Sa Truall 2000M<sup>2</sup> Nga kjo : Sa Ndërtesa 450M<sup>2</sup>  
Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

**KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË**

Zoti ( Zotërinjtë )	Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
	<u>SHOQËRIA " KASA CONSTRUCTION - SH.P.K.</u>				<u>BARJHAS</u>
	<u>NIKOLIN RIZA KASA</u>			<u>50%</u>	<u>L. LESME PERIX</u>
	<u>KASIM</u>			<u>50%</u>	<u>" "</u>
	<u> </u>		<u> </u>	<u> </u>	<u> </u>

- është pronar i -  
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart TE PASURISË NR. 32/15  
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi -  
- kufizimet e pasurisë janë : V TO . L 68 . J 32/4, 32/12 . P 32/4, 32/5


Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.  
Data e lëshimit të çertifikatës 26.07.2010

Lëshuesi i çertifikatës  
REGJISTRUESI  
(SULEJMAN DERRIUSHI)


[Signature]

EKSPERTI I NJËDISI  
KASA  
SH.P.K  
1029282041  
ELBASAN

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT  
(Fragment)

<p>ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJSHME</p> 	<p>A. IDENTIFIKIMI I PASURISE</p> <p>ZONA KADASTRALE <u>1112</u> NR. I PASURISE <u>32/6</u> Vol. <u>5</u> Fq. <u>8</u></p> <p>INDEKSI I HARTES <u>K-34-100-232-8</u> SHKALLA <u>1:2500</u></p> <p>ADRESA E PASURISE: Rrethi <u>TERRIN</u> Q/ F <u>BARAKAJ</u></p> <p>Rr/L _____ PG _____ Sb _____ K _____ Ap _____</p>
	<p>B. KUFIZIMET</p> <p>V. <u>70</u> SHprehja KASA CONSTRUCTION SH.PK.</p> <p>L. <u>68</u> KIKOLIN KASA</p> <p>J. <u>32/4, 32/12</u> KASEM <u>u</u></p> <p>P. <u>32/4, 32/5</u></p> <p>D. Data: <u>26/07/2010</u>, Ora: <u>10<sup>30</sup></u></p>

Sip. = 4416m<sup>2</sup> ABB + TBUALL



EKSPERT MEDISI  
LORENA  
SH. P. K.  
029282041  
ELBASAN





# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

## ÇERTIFIKATË PËR VËRTETIM PRONËSIE

155869

Zyra e Regjistrimit TE RIN Zona Kadastrale Nr. 1112  
 Numri i Pasurisë 6/44 Volumi 5 Faqe 181  
 Adresa e Pasurisë BARANAS  
 Lloji i Pasurisë ARE  
 Sipërfaqja Totale 3205M<sup>2</sup>  
 Nga kjo : Sa Truall - Nga kjo : Sa Ndërtesa -  
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

### KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zotë ( Zotërinjtë )

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
DHOQERIA "KASA CONSTRUCTION" SA.P.K. BARANAS-GROCAJ				
NIKOLIN	RIZA	KADA	1/2	LASJA QESME TRON
2-KASEM	"	"	1/2	" " " "

- është pronar i -
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart TE PASURISË NR. 6/44
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi -
- kufizimet e pasurisë janë : V 6/2 L 6/20 J 70 P 66

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 11.03.2010 Nr. 759

Data e lëshimit të çertifikatës

11.03.2010



EKSPERTI VYDISI  
1029/0204T  
ELBASAN

### **3. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT**

Në mbështetje të Ligjit Nr.10440 datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", bazuar gërms  
d) Depot e Skrapit të hekurit, përfshirë ato nga automjetet; të pikës 11 të Shtojcës 2 : "Projekte që I  
nënshtrohen procedurës paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis"

Shoqëria "KASA CONSTRUCTION me NIPT L08707101F zotëron një leje të vjetër mjedisi për "Pikë  
magazinimi dhe tregtimi për material ndërtimi" Kodi III.1.B datë 21/02/201. Kjo shoqëri kërkon të  
ushtrrojë një veprimtari në fushën e magazinimit , rekuperim të hekurishteve/skrapeve të metalit ose  
cmontim I mbetjeve nga motorët e makinave, në fund të jetës, për këtë arsye kërkon të rishikojë Lejen e  
Mjedisit Tipi B.

Impianti I autodemontimit dhe qendra e grumbullimit të mjeteve të përdorura në fund të jetës së tyre  
është vendosur në ambientet e shoqërisë "KASA CONSTRUCION" në Fshatin Bardhaj, Peqin, Elbasan.

Impianti ndahet sipas sektorëve të mëposhtëm:

- ✓ Sektori I zyrave dhe shitjeve
- ✓ Zyra teknike
- ✓ Sektori për referimin fillestar të mjeteve që do të trajtohen
- ✓ Sektori I trajtimit të makinave jashtë përdorimit
- ✓ Sektori I magazinimit të automjeteve të trajtuara
- ✓ Sektori I mgazinimit të mbetjeve të rreikshme dhe jot ë rrezikshme
- ✓ Sektori I demontimit me zvogëlim vëllimi dhe zonave të magazinimit
- ✓ Sektori I pranimit të pjesëve të këmbimit

Linja egzistuese përfshin:

1. Pajisjet e gazit dhe metanit, e gjithë pajisja është e vendosur në sektorin e trajtimit të  
autometjeve jashtë përdorimit dhe përdoret për nxjerrjen e gazrave dhe për serbatorët e gazit  
për autovetura
2. Presë për zvogëlimin e volumit të automjeteve
3. Presë për ngjeshjen e automjeteve
4. Ngarkues me kapje dhe/ose magnet për mjetet rrugore
5. Makineria e cmontimit
6. Rekuperatorët multigas për gaz refrigeranti
7. Piruni
8. Pajisje të ndryshme elektrike manual
9. Kazanë të lëvizshëm për ruajtjen e llojeve të ndryshme të mbetjeve
10. Makina larëse



EKSPERTI MJEDISI  
LORIANA  
SH. P. U.  
L02928204T  
ELBASAN



Mbetjet qe do te trajtohen ne kete objekt, aktivitet ky per te cilin shoqeria "Kasa Construction" shpk kerkon te pajiset me leje mjedisore sipas ligjeve shqiptare ne fuqi, jane te identifikuara sipas **Vendimit Nr. 99, date 18.2.2005 "PER MIRATIMIN E KATALOGUT SHQIPTAR TE KLASIFIKIMIT TE MBETJEVE"** ne Katalogun Europian te Mbetjeve (KEM) me kodin 16.01.04\* - "**Automjetet jashte perdorimit**". Per KEM 16.01.04\*, operacionet e ndjekura ne impiant jane te identifikuara dhe te specifikuara si me poshte:

- D13 Rigrupime paraprake te operacioneve te pikave D1 deri D12;
- D14 Rikushtezime paraprake perpara njerit prej operacioneve te pikave D1 deri D13;
- D15 Depozitimet paraprake te nje prej operacioneve te pikave D1 deri D14.

Per pjeset e mbetjeve qe do te dergohen per rikuperim si psh, vaji, bateria, antifrizja, etj.. do te kryhen operacionet e rikuperimit ekskluzivisht te vendosur ne reserve:

- R13 Vendosja ne reserve e mbetjeve per paraqitjen e nje prej operacioneve te treguara pikat R1 dhe R12 ( me perjashtim te depozitave te perkohshme, perpara grumbullimeve, ne vendet ne te cilat jane prodhuar)
- R4 riciklimi/rikuperimi I metaleve dhe I elementeve me perberje metali.

#### **Tonelata te pergjithshme dhe numri I autovecurave qe do te trajtohen.**

Sasite ne hyrje te impiantit qe Kompania kerkon te trajtoje jane rreth 1000 automjete ne vit me peshe mesatare rreth 900 kg me nje total rreth 900 ton ne vit. Ne tabelen e meposhteme jepen te dhena per llojin e mbetjeve qe dalin nga demolimi i automjeteve ne fund te jetes, i cili eshte aktiviteti qe do te kryhet nga shoqeria "Kasa Construction" sh.p.k ne kete objekt.

<b>PERBERESIT E PESHES</b>	<b>PESHA MESATARE E UNIFIKUAR</b>
Vaji i perdorur (motor dhe kambio)	4.1 lit
Vaj frenash	0.13 lit
Leng antifrizje	3.1 lit
Bateri	9.9 kg
Vaj hidraulik	0.04 kg
CFC (qazi i kondicionerit)	0.006 kg
Airbag	0.5 kg
Bombula qazi	0.4 kg
Karburant	3.2 lit
Goma	32 kg
Xhama	22 kg
Veshie sedilie	2.2 kg
Parakolpe	6.1 kg
Riveshie te ndrvshme	19.2 kg
Serbatore karburanti	3.1 kg
Vasketa per ujin e xhamave dhe te ftohjes se motorrit	1.2 kg
Mbaitese e filtrit te airit	0.6 kg
Passaruote (harae)	0.2 kg
Timon	0.6 kg
Motor	133 kg
Pjese te tiera	208 kg
Karkasa	436 kg

EKSPERT MJEDISI  
 L. PERMA  
 10/02/2014  
 ELBASAN

**Mbetje te dala gjate rekuperimit/asgjesimit te automjeteve ne fund te jetes**

Tipet e mbetjeve te prodhuara nga aktiviteti i autodemontimit te marra nga rikuperimi ose asgjesimi jane si me poshte:

KODI KEM	PERSHKRIMI	TRAJTIMI
13 01 10*	Vaj mineral per qarqe elektrike jo i kloruar	R13
13 01 11*	Vaj sintetik per qarqe hidraulike	R13
13 01 13*	Vajra te tjere per qarqe hidraulike	R13
13 02 05*	Mbetje te vajrave minerale per motorre, ingranazhe dhe lubrifikante jo te kloruar	R13
13 02 06*	Mbetje te vajrave sintetike per motorre, ingranazhe dhe lubrifikante	R13
13 02 07*	Vajra motorrash, ingranazhe dhe lubrifikante lehtesisht te biodegradueshem	R13
13 02 08*	Te tjera vaj motorresh, ingranazhe dhe lubrifikante	R13
16 01 03*	Goma te marra nga asgjesimi / rekuperimi	R13
16 01 06*	Automjete jashte perdorimit, qe nuk permbajne lengje te rrezikshme	R14-R13
16 01 07*	Filtra vajrash	R13-D15
16 01 08*	Pjese me perberje merkuri	R13-D15
16 01 10*	Pjese shperthyese (psh airbag)	R13-D15
16 01 11*	Pastilje frenash, me perberje amianti	R13-D15
16 01 12*	Pastilie per frena te ndryshmenga ato te zerit 16 01 11*	R13
16 01 13*	Leng frenash	R13-D15
16 01 14*	Leng antifrizme me perberie substance te rrezikshme	R13-D15
16 01 15*	Lengje antifrizme te ndryshme nga ato te zerit 16 01 14*	R13-D15
16 01 16*	Serbatore per gaz te lengshem	R13
16 01 17*	Metale merkuri	R4-R13
16 01 18*	Metale hekuri	R4-R13
16 01 19*	Plastike	R13
16 01 20*	Xhama	R13
16 01 21*	Perberes te rrezikshem te ndryshem nga ato te zerave nga 16 01 07* tek 16 01 11*; 16 01 13* dhe 16 01 14*	R13-D15
16 01 22*	Perberes qe nuk jane te specifikuar	R13
16 06 01*	Bateri plumbi	R13
16 08 01*	Katalizatore te ezauruar qe permbajne metale flori, argjend, renium, radium, palladium, iridium ose platin (pervec 16 08 07*)	R13
16 08 02*	Katalizatore te ezauruar qe permbajne metale te rrezikshme tranzicioni ose komponentet metalike tranzicioni te rrezikshem	R13-D15
16 08 03*	Katalizatore te ezauruar qe permbajne metale tranzicioni ose komponentet metalike tranzicioni jo te specifikuar ndryshe	R13
16 08 05*	Katalizatore te ezauruar qe permbajne acid florik	R13-D15
16 08 07*	Katalizatore te ezauruar te ndotur nga substance te rrezikshme	R13-D15

EKSPERT MEDISI  
 102928204T  
 BASAN



## Mbetjet metalike dhe jo metalike te siguruara nga demontimi i automjeteve:

Mbeturina hekuri	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Karkasa veturash te bonifikuara, te cilat permbajne plastika dhe goma;</li> <li>• Pjese te tjera makinash te cilat nuk permbajne papasterti</li> </ul>
Mbeturina jo hekuri	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Alumin, pjese makinash (qarqe, ingranazhe, timona, kambio, etj);</li> <li>• Kabllo bakri</li> </ul>
Mbeturina metaliket e perziera	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Radiatore ftohes te ndryshem bakri</li> <li>• Radiatore ftohes te ndryshem alumini</li> <li>• Radiatore ftohes te ndryshem gize/alumin</li> <li>• Motorre dhe kambio te ndryshme celik/alumin</li> </ul>
Pjese kembimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Perberes te destinuar per perdorim per te njejtin qellim per te cilin ishin projektuar</li> </ul>
Bateri plumbi	
Vajra te perdorur	
Karburante	
Leng frenash	
Leng Antifrize	
Leng per larjen e xhamave	

### Artikulimi I zonave funksionale te impiantit

Cdo sektor ne kantier do te funksionoje sipas rregullave qofte per mjedisin apo per sigurine ne pune, duke mbajtur parasysh aktivitetet e kryera dhe pershtatshmerisht te percaktuara ne funksion te puneve te kryera.

Me mbylljen e impiantit do te parashikohet nje plan restaurimi me qellim garantimin e perdorshmerise se kantierit ne koherence me destinacionet urbanistike te zones.

Impianti do te garantoje prezencen e nje personeli te kualifikuar dhe te trajnuar mjaft mire per menaxhimin e mbetjeve te vecanta duke evituar hedhjen e tyre ne mjedis.

Permasat dhe karakteristikat e impiantit te demontimit, nder te tjera do te jene te tilla qe te sigurojne:

- Ruajtjen e duhur te pjeseve te cmontuara dhe ruajtjen mbi siperfaqe te pershkrueshme nga pjeset e bera pis nga vaji;
- Ruajtjen e akumulatoreve ne kontenitore te posacem;
- Ruajtjen ne menyre te ndare te sebratoreve te vecante, te lengjeve, qe dalin nga makinat jashte perdorimit si, karburantet, vaj motorri, vaj kambio, vaj transmisioni, vaj hidraulik, leng ftohes, anifrize, leng frenash, acidin e akumulatoreve, lengje te sistemit te kondicionerit dhe lengje te tjera qe permban automjeti.
- Ruajtje te duhur per gomat jashte perdorimit.

Zona e kesaj zone grumbullimi eshte e organizuar ne menyre qe te identifikohen sektoret e meposhtem:


- a) Sektori I pranimit te automjeteve dhe magazinimi I tyre perpara trajnimit;
- b) Sektori I trajtimit;
- c) Sektori per depozitimin e pjeseve te kembimit te rikuperuara;
- d) Sektori I shkaterrimit nepermjet shtypjes dhe zvogelimit te vellimit;
- e) Sektori per ruajtjen e mbetjeve te rikuperueshme(karkasa te drenazuara,
- f) plastika,xhama,goma etj.);
- g) Sektori per ruajtjen e mbetjeve te rrezikshme(vajra, bateri, lengje ftohes, filtra, etj)

EKSPERTI MED SI  
 SH. RMA  
 SH. PAK  
 102/282041  
 ELBASAN

## Trajtimi, seleksionimi dhe cmontimi per qellim riciklimi

Pas realizimit te proceseve te mesiperme, automjeti do te trajtohet perseri me qellim garantimin e riciklimit dhe te rikuperimit te komponenteve dhe materialeve te tij. Gjithashtu do ti hiqen katalizatoret, komponentet metalik qe permbajne baker, alumin, magnez, gomate, xhamat dhe ne fund te gjithe pjeset e medha plastike (parakolpet, kroskoti, serbratoret e lengjeve, etj) per tu marre me pas nga firmat e riciklimit.

### SKEMA TEKNOLOGJIKE





## **Menaxhimi, monitorimi dhe kontrolli I impiantit**

Autonjetet e siguruara duke pritur per veprimet e rimekembjes dhe trajtimit final per reduktimin e volumit, do te vendosen deri ne nje maksimum prej tre automjeteve ne varesi te stabilizimit te kushteve dhe siguride se punetoreve.

- Karkasat qe jane reduktuar vellimi final dhe stivosur deri ne jo me shume se 5 metra lartesi.
- Ruajtja e automjeteve per te bonifikuar do te kete nje kohezgjatje maksimale prej 180 diteve, para vendosjes ne siguri.
- Ruajtja e baterive do te kete nje kohezgjatje maksimale prej 360 ditesh.
- Pjeset e kembimit me destinacion per marketing do te ruhen Brenda zonave te mbuluara
- Pjeset e cmontuara per rikuperim duke perfshire ato te ndotura nga vajrat dhe qe permbajne dhe lengje fluide jane ruajtur sic duhet ne menyre qe te mos shkaktojne ndotje ne mjedis nga komponente te rrezikshem.
- Periodikisht pergjegjesi teknik I impiantit duhet te kryej kontrole per te verifikuar ruajtjen e kerkesave te sigurise te qendres me vemendje te vecante mbrojtjes se paisjeve levizese dhe elektrike, materialet e stivosura, integriteti I konteniervave te mbeturinave, efikasiteti I mjeteve levizese dhe heqese.
- Cdo vit pergjegjesi per menaxhimin e Sistemit te Sigurise Ndemarrjes do te kryej kontrollet e parashikuara ne ligjet ne fuqi.

## **Kriteret e magazinimit (ruajtjes)**

Menyra e ruajtjes se mbetjeve te pershtatshme dhe te realizuara ne kushte te sigurta kontribuojne ne reduktimin e gjenerimit te shkarkimeve te padeshiruara dhe rreziqet e derdhjes. Magazinimi ne baze te llojeve homogjene eshte e nevojshme per te shmangur aksidentet per shkak te reagimit te substancave te paperputhshme mes tyre dhe sin je mase per te parandaluar ngjarjet aksidentale, gjithashtu per te garantuar rekuperimin me efikasitet te disa materialeve.

Ruajtja e mbetjeve Brenda ndermarrjes se demontimit, pergjithesisht duhet te jete ne perputhje me parimet e pergjithshme te caktuara:

Te gjitha fushat e trajtimit, magazinimit te pjeseve te kembimit, e te depozitimit te mbetjeve te rrezikshme qe vijne nga demontimi I automjeteve do te vendosen ne zona te shtruara dhe te mbuluara ndersa sheshi per ruajtjen e automjeteve per te siguruar ne pritje te trajtimit perfundimtare.

Mbetjet do te grumbullohen ne zona te ndara.

Per baterite ruajtja do te kryhet nga konteniervave te vecante te perbere prej polietilene me densitet te larte I papershkueshem nga uji dhe rezistent nga acidet te permbajtura ne bateri te rikarikueshme te mbaruara

EKSPERTI MJEDISI  
LUE RMA  
SHEVA  
102028204T  
ELBASAN

Ruajtja e mbetjeve te rikuperuara do te realizohen ne menyre te tille qe te mos modifikohen karakteristikat e mbetjeve dhe qe te mos pengojne mbledhjet e tjera

Karkasat e automjeteve qe I nenshtrohen vendosjes ne siguri dhe ne te cilat trajtimi eshte kryer do te vendosen njera mbi tjetren me nje latesi maksimale 5 metra. Menaxhimi I HCF dhe CFC do te kryhet conform ligjit ne fuqi.

### **Masat e marra per sigurine dhe higjenen e ambientit**

Qe te perputhen me kerkesat e legjislacionit ne fuqi nderhyrjet per rregullimet e parashikuara ne lenden e sigurise dhe higjenes ambientale te Kompanise jane te meposhteme:

- Pershtatje me normat e Sigurise kundra Zjarrit leshuar nga Ministria e Brendshme
- Trajtimi I ujrave te perdorur me ane te depuratoreve te vendosur ne toke per filtrimin e ujrave
- E gjithë fabrika eshte e paisur me tabela sinjalizuese
- Te gjitha impiantet jane te instaluara mjeshterisht sipas legjislacionit ne fuqi.
- Te gjitha impiantet teknologjike jane instaluar ne menyre qe te mos shkaktojne shqetesime akustike.
- I gjithë personeli eshte I paisur me mjete te pershtatshme per mbrojtjen individuale dhe mbahen te veshura nga punetori.

Perfundimisht mund te themi se qendra e grumbullimit dhe trajtimit te automjeteve jashte perdorimit lejon me aktivitetin e bonifikimit dhe asgjesimit, fillimin e rikuperimin e materialeve te cilat pa pranine e kesaj qendre do te humbisnin pergjithmone me pasoje deme ekonomike si dhe deme ekologjike.

Ne vizionin e menaxhimit mjedisor Kasa Construction shpk synon te krijojë klime te shendetshme pune, ambiente te pastra dhe komode dhe te sigurojë parandalimin e ndotjeve nepermjet nje menaxhimi te kujdesshem te demontimit te automjeteve.

Analizat, konsideratat dhe vleresimet e kryera cojne ne perfundimin qe aktiviteti I qendres se autodemontimit nuk ndikon negativisht mbi ndonje nga aspektet mjedisore te marra ne konsiderate dhe kane evidentuar mungesen e burimeve te rendesishme te ndikimit mbi floren, faunen, peisazhin dhe komponentet antropogjen te territorit.

EKSPERTI MJEKEDISI  
L. SH. P. K.  
LOB 28204T  
ELBASAN



## MATRICA E VNM-se

Ne kete Kapitull jepet nje Matrice VNM-je qe ka permbledhur ceshtjet kryesore te ngritura nga vleresimi i ndikimit te projektit te linjes grumbullimit dhe demontimit te automjeteve ne fund te jetes, si dhe grumbullimin dhe perpunimin e skrapit.

Matrica e VNM-se analizon:

- Seklorin e prekur mjedisor;
- Percaktimi i sasise, nese eshle e mundur, ose kualifikimi i ndikimit;
- Lloji i ndikimit (lokal/rajonal, perkohshem/i perhershem, prapsueshem/i pa prapsueshem);
- Pershkrimi i ndikimit dhe/ose masat lehlesuese te adoptuara nga projekti per te reduktuar ose minimizuar magnituden e ndikimit.

## PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

Plani i Menaxhimit Mjedor (PMM) synon qe te verifikojte perputhjen e Projektit gjate fazes se ndertimit me efektshmerine mjedisore te funksionimit te linjes grumbullimit dhe demontimit te automjeteve, si dhe grumbullimit dhe perpunimit te skrapit.

Aktivitetet kryesore monitoruese te parashikuara nga PMM jane pershkruar ne vijim. Nese do tendodhin mosperputhje, do te ndermerren masat e duhura korrigjuese.

Masat lehtesuese dhe kompensimi gjate fazes se ndertim-montimit Udhezime per Planet e Veprimit te Kontraktoreve

Gjithashtu, Plani per Menaxhimin Mjedor do te tregojte procedurat per sa i takon:

- Organizimit te personit pergjegjes per ceshtjet mjedisore;
- Hyrja ne Objekt dhe Informimi Mjedor i personelit qe punon ne linjen e grumbullimit dhe demontimit te automjeteve, si dhe grumbullimit dhe perpunimit te skrapit.

Si nje minimum, kurse si akses do te perfshijne:

- Informacion per pajisjet e punimeve qe do te perdoren;
- Informacion per substancat qe do te perdoren;
- Informacion per cdo pajisje personale mbrojtese qe do te perdoret;
- Informimi mjedor (menaxhimi i mbetjeve, reaksionet nga derdhja e vajrave, etj.); Praktikate mira ne kantier (mirembajtja, kontrolli i zhurmave, kursimi energjise, etj.)

EKSPERTI MJEDISOR  
LORIANA  
SHARRA  
02/02/2024  
ELBASAN

Procedurat mjedisore (te perfshira ne EMP ose ne dokumenta specifike ku eshte e nevojshme) per ceshtjet qe vijojne:

- Menaxhimi i mbetjeve;
- Emetimet ne ajer;
- Uji i mbetjeve;
- Ndotja e tokes;
- Perdorimi i lendeve te para dhe burimeve natyrore;
- Zmontimi i kantierit dhe perkujdesja e metejshme;
- Reagim ndaj emergjencave;
- Monitorimi, auditimi dhe inspektimi
- Shenime mjedisore dhe raportimi.

#### *Menaxhimi i Mbetjeve, Derdhjeve dhe Trafikut*

Duke ju referuar menaxhimit te mbetjeve, do te pergatitet nje Plan nga Subjekti per te siguruar se procedurat e menaxhimit per te gjitha llojet e mbetjeve jane te perkufizuara dhe i komunikohen personelit qe operon ne vend.

Metodat per largimin e mbetjeve do te percaktohen ne lidhje me autoritetet vendore dhe kontraktoret perkates per largimin e mbetjeve.

Plani per Menaxhimin e Mbetjeve do te perfshije te gjitha llojet e mundshme te mbetjeve te prodhuara ne vend.

#### Ne vecanti:

Kamionet me mbulese do te sherbejne per transportimin e dheut;

Rruget e sherbimit do te shtrohen me material te ashper;

Personeli i kantierit duhet te jete ne dijeni se shkarkimi i kamioneve do te realizohet ngadale, me qellim qe te minimizohet formimi i pluhurit;

Ne rastin e kushteve shume te thata, material i grumbulluar do te sperkatet me uje.

#### *Plani i Menaxhimit te Trafikut/Aksesit*

Perpara se te filloje punimet e montimit, subjekti do te verifikoje nese kushtet e rrugeve dhe urave jane te pershtatshme per nje transport te sigurte te mjeteve dhe paisjeve.

Per meteper, kontraktori do te:

Vendose limitet e shpejtesise;

Perdore kamione te mbuluar;

Imponoje mirembajtjen e sigurise se automjeteve dhe plotesoje kushtet e ngarkeses;

Percaktoje zonat e duhura te parkimit;

Ndaloje shkarkimin e pavrojtuar te automjeteve.

EKSPERTI MJEDISOR  
LIDERMAN  
SHKURTI  
L029082041  
TIRANA



*Plani ne Rastin e Derdhjes se Ndotsve*

Kontraktoret do te verifikojne nese cdo ngarkim/shkarkim drejtohet ne menyre te sigurte.

*Ne menyre te vecante:*

*Derdhja ne toke ose ne kanale e vajit, diesel-it, dhe e cdo kimikati eshte e ndaluar ne menyre te prere.*

Zonat e furnizimit me karburant duhet te kene nje siperfaqe te forte, te papershkueshme qe kullon ne nje interceptor vaji. Ato duhet te ndodhen jo me pak se 50 m nga cdo vije uji.

Perdorimi i siperfaqeve te papershkueshme, platform kullimi, etj. per te parandaluar ndotjen ne toke nga automjetet stacionare.

Gjithashtu, veprimet qe vijojne duhet te zbatohen ne rastin e nje derdhjeje per te parandaluar ose moderuar ndikimin mjedisor qe mund te linde;

Ndalimi punimeve deri ne krijimine kushteve te sigurta;

Eliminimi i shkakut te derdhjes, dhe ne te njejten kohe, garantimi i sigurise tuaj dhe te njerezve te tjere;

Parandaloni lengjet nga rrjedhja ne kanale te rruges, lumenj, ose ne sistemin e kanalizimeve permes qeseve plastike dhe materialeve te tjera;

- Ngrini materiatet me sistemet e duhura, vendosini ato ne thase ose konteniere te papershkueshem nga uji dhe dergojini ato ne kontenierin e mbetjeve te rrezikshme (toka e ndotur ne menyre te rastesishme mund te hiqet deri aty ku ka penetruar lengu).

*Programi per Menaxhimin e Materialeve te Rrezikshme*

Cdo produkt kimik do te furnizohet me MSDS e vet (ne gjuhen angleze, dhe gjuhen vendase, sa here qe te jete e mundur). Nje kopje MSDS e te gjitha kimikateve do te shperndahet ne zonat e magazinimit. Seksioni i MSDS (Informacioni Transportit) paraqet klasen e rrezikut te transportit per ato substanca qe paraqesin nje rrezik fizik sipas Rekomandimeve te KB mbi Transportin e Mallrave te Rrezikshme. Materiatet e rrezikshme do te etikohen dhe shenohen rregullisht sipas legjislacionit perkates.

Kriteret qe vijojne do te adoptohen per magazinimin e kimikateve te rrezikshme:

- Zonat e magazinimit te materialeve te rrezikshme duhet te identifikohen, etiketohen dhe shenohen sic duhet;
- Hapesirat e magazinimit duhet te parashikohen me sistemin e mbajtjes se derdhjeve;
- Kurbat mbartese duhet te jene te pranishme perreth zones se ngarkimit dhe shkarkimit;
- Zona e magazinimit duhet te jete e shtruar, c rrethuar dhe e shenuar;
- Zona e magazinimit duhet te jete e pajisur me nje kuti emergjence;
- Materialet e pa-pajtueshme duhet te ndahen ne perputhje me kerkesat e vecimit ndermjet klasave te ndryshme te mallrave te rrezikshme;
- Inspektimet duhet te kryhen periodikisht me qellim qe te verifikohet ndonje vrime e mundshme qe mund te coje ne derdhje.

EKSPERTI MJEDISOR  
SULEJMAN  
102928204T  
ELBASAN

### Menaxhimi i Shendetit dhe Sigurise

Kontraktoret duhet t'u adresohen me kujdes ceshtjeve te Shendetit dhe Sigurise. Me qellim qe te mbrohet zona e kantierit nga aksesit i pa-autorizuar, do te vendoset nje rrethim perimetrat sigurie dhe shenja paralajmruese perreth gjithe zones se punimeve. Aksesit do t'u sigurohet vetem personetit te autorizuar, i cili do te ekspozoje karten e duhur te identifikimit.

Perpara se te filloje punimet, personeli do te marre trajnimin e duhur mbi rreziqet e mundshme.

Gjate punimeve, personeli duhet te veshet PPE e duhur.

## **14. MASAT LEHTESUESE DHE KOMPENSIMI GJATE FAZES OPERACIONALE**

### *Masat Lehtesuese Mjedisore dhe Kompensimet Cilesia e Ajrit*

Procedurat specifike dhe instruksionet operationale do te zbatohen brenda EMP, me qellim qe te percaktoje rolet dhe pergjegjesite per te siguruar pajtueshmerine per emetimet ne ajer.

#### *Toka*

Te gjitha zonat e magazinimit do te shtrihen dhe pajisen, nese eshte e nevojshme, me basene bartese me kapacitetin e duhur, duke shmangur ndotjen e mundshme te dheut dhe ujrave nentokesore.

#### *Uji*

Objekti eshte projektuar duke marre ne konsiderate disa sisteme per te parandaluar shkarkimet e ujrave te ndotur ne zonen perreth:

- Impianti trajtimit te ujrave te linjes se demontimit;

#### *Zhurma*

Gjate operimit, cdo mase lehtesuese e nevojshme me tej do te adoptohet per te reduktuar ndikimin e zhurmes se prodhuar nga impianti.

Inspektime periodike per monitorimin e zhurmes do te realizohen per te kontrolluar dhe minimizuar ndikimin e zhurmes.

#### *Mbetjet*

Menaxhimi i mbetjeve do te bazohet ne perqasjen e minimizimit te mbetjeve, sic eshte parimi ALARP, me objektivin per te reduktuar volumen dhe toksicitetin e mbetjeve te prodhuara deri ne masen qe eshte praktike ekonomikisht.

Kjo do te behet duke zbatuar strategjite per minimizimin e mbetjeve.

#### *Emergjenca dhe Plani i Gadishmerise*

Emergjenca ne kete kontekst nenkupton rastet e zjarrit dhe ato mjekesore (ose situata te demeve madhore te prones).

Kontraktori do te inspektojte zonen e punimeve dhe do te regjistroje detajet qe vijojne:

- Numrin dhe vendosjen e daljeve;
- Rrugjet e udhtimit drejt seciles dalje;
- Vendndodhjen dhe llojin e makinerive zjarr-fikese (zjarrfikeseve, panelit per alarm zjarri, pikave manuale per thirrje telefonike), ndihmen e pare;
- Nje vendndodhje te pranueshme jashte zones se punes per nje pike grumbullimi.

EKSPERTI MJEDISOR  
LOERNA  
SHPK  
1021928204T  
ELBASAN



Per mbledhjen e informacionit te mesiperm, Kontraktori do te hartoje, ne nje shkalle te duhur, zonen e vendndodhjes, me treguesin per numrin e dhomave, panelin e alarmit te zjarrit, pikave te thirrjeve telefonike, pajisjet zjarr-fikese, daljeve, rruget e udhetimeve drejt atyre daljeve (perfshi shkallet, nese jane te pranishme) dhe pika e grumbullimit.

Procedurat specifike per pergjigje emergjente do te shkruhen dhe i gjithë personeli i perfshire do te jete ne dijeni te tyre.

## 15. MONITORIMI MJEDISOR DHE RAPORTIMI

### *Cilesia e Ajrit*

Duke marre ne konsiderate periudhen e kufizuar kohore te kohes se aktiviteteve te ndertim-montimit dhe sistemin e tyre tipik jo te vazhduar, nuk ka emetime te vazhduara qe do te monitorohen. Kontraktori do te monitoroje emetimet ne ajer nga shkarkimet e automjeteve dhe makinerive te tjera. Monitorimi do te konsistoje ne verifikimin visual per tymin e zi ne shkarkime perpara dhe gjate aktivitetit. Kujdes i vecante do te behet per aresye shendetesore ne monitorimin dhe kontrollin e pluhurave. Ne rast se emetimet e dukshme duhet te jene te pranishme nga shkarkimet, pajisje/makinerite respektive do te ndalohen dhe zevendesohen; sa me teper qe te jete e praktikueshme.

Nuk eshte parashikuar asnje aktivitet raportimi.

### *Dheu*

Procedurave dhe masave lehtesuese per te shmangur shkarkimet e ngurta dhe te lengeta ne toke gjate fazes se ndertim-montimit u jemi adresuar ne seksionet e tjera te ketij dokumenti.

### *Uji*

Duke marre ne konsiderate periudhen e kufizuar kohore te kohes se aktiviteteve te ndertimit dhe sistemin e tyre tipik jo te vazhduar, nuk ka asnje shkarkim te perhershem uji per t'u monitoruar.

Nuk eshte parashikuar asnje aktivitet raportimi.

### *Zhurma*

Emetimet e zhurmës gjate fazes se ndertim-montimit jane per shkak te makinerive/pajisje. Makinerite ne punimet ne impiant qe jane me motorra me djegie duhet te pajisen me masat kunder zhurmes nese ate do te perdoren brenda 50 m nga blloqet e banimit.

### *Mbetjet*

Duke marre ne konsiderate periudhen e kufizuar te kohes se aktiviteteve te ndertimit dhe te sistemit te tyre tipik jo te vazhduar, prodhimi i mbetjeve lidhet me aktivitetet e pastrimit te ambienteve te impiantit.

Nuk jane parashikuar aktivite raportuese.

### *Faza e Funkjonimit Cilesia e Airit*

Nje raport vjetor me nje sinteze te te dhenave te emetimeve do t'i dergohet autoritetit kompetent. Raporti do te permbaje bazen e informacionit te nevojshem per te vleresuar pajtueshmerine me legjislacion perkates ne fuqi.

EKSPERTI MJEDISOR  
LOERVA  
SH.P.K.  
LO/0282041  
FYBASAN

### *Toka*

Vendndodhja do te verifikohet periodikisht nepermjet inspektimeve ne vend, me qellim qe te sigurohet se rruget dhe shtresat do te mbahen ne kushtet e mira. Cdo dem ose perkeqesim i zones se mbuluar do te vihet menjehere ne dukje dhe do te riparohet.

Ne cdo rast, procedurat dhe masat lehtesuese per te shmangur shkarkimet e ngurta dhe te lengeta ne dhe u adresohen seksioneve te tjera te ketij dokumenti.

Nuk jane parashikuar aktivite raportuese.

### *Uji*

Te gjithe parametrat e rregulluar per shkarkimin e ujrave te perdorur do te maten periodikisht.

Gjithashtu, do te kryhen fushata periodike per marrjen e kampioneve ne zonen prane pikes se shkarkimit, me qellim qe te verifikohen ndikimet e mundshme.

### *Zhurma*

Pas fillimit te funksionimit te linjes se grumbullimit dhe demontimit te automjeteve, si dhe grumbullimit dhe perpunimit te skrapit, do te kryhen nje sere matjesh te zhurmes ne receptoret me te prekur perreth objektit. Ne rast te tejkalimeve te limiteve, do te perkufizohen veprime korigjuese.

Matjet e zhurmes do te kryhen ne vijim te standarteve nderkombetare (sic eshte ISO) dhe rezultatet do te jene ne dispozicion te autoritetit kompetent.

### *Mbetjet*

Do te mbahet nje ditar i detajuar i mbetjeve te prodhuar (tipi, sasia, burimi i detajuar). Mbetjet do te largohen nga kompanite e autorizuar ne perputhje me rregullat shqiptare. Ne fund te cdo viti, do te pergatitet nje raport, me qellim qe te kontrollohen drejtimit e prodhimit dhe te zbatohen, nese jane te nevojshme, masat e duhura te reduktimit.

## **16.Konkluzione**

Qendra e grumbullimit dhe trajtimit te automjeteve jashte perdorimit lejon me aktivitetin e bonifikimit dhe asgjesimit, fillimin e rikuperimin e materialeve te cilat pa pranine e kesaj qendre do te humbisnin pergjithmone me pasoje dem ekonomike si dhe dem ekologjike.

Ne vizionin e menaxhimit mjedisor Kasa Construcion shpk synon te krijojte klime te shendetshme pune, ambiente te pastra dhe komode dhe te siguroje parandalimin e ndotjeve nepermjet nje menaxhimi te kujdesshem te demontimit te automjeteve.

Analizat, konsideratat dhe vleresimet e kryera cojne ne perfundimin qe aktiviteti i qendres se autodemontimit nuk ndikon negativisht mbi ndonje nga aspektet mjedisore te marra ne konsiderate dhe kane evidentuar mungesen e burimeve te rendesishme te ndikimit mbi floren, faunen, peisazhin dhe komponentet antropogjen te territorit.

Ekspert Mjedisor  
J. OFERMAN  
SH. PAK  
NO 290/2004  
ELI HAN